



**Data: 06/09/2024**

**PROCESVERBAL – TIPI I KONTRATËS - MALL  
PROCEDURË E HAPUR MBI KUFIRIN E LARTË MONETAR  
PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE  
PËR KUALIFIKIM**

**OBJEKTI I PROCEDURËS: “ZËVENDËSIMI I NDARËSAVE, TRANSFORMATORËVE TË TENSIONIT, RRJETAVE RRETHUESE, ZBARAVE FLEKSIBËL DHE GJITHË ELEMENTËVE TË TJERË TË ZBARAVE 13,8 KV TË 4 AGREGATËVE NË HEC FIERZË”.**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): PAJISJE TË NDRYSHME -39300000-5.**

**VLERA E FONDIT LIMIT:** 47,900,000 (Dyzet e shtatë milion e nëntëqind mijë) Lekë pa TVSH ose 480,296.801 (Katërqind e tetëdhjetë mijë e dyqind e nëntëdhjetë e gjashtë pikë tetëqind e një) Euro pa TVSH.

***Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë në datën 06/09/2024 është 99.73 Lekë/Euro.***

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor Korporata Elektroenergjitike Shqiptare sh.a, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

## **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

### **1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

*a. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

*b. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8;*

### **Argumentimi:**

Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82, “Formulari përmbledhës i vetdeklarimet” dhe Nenit 83 “Sigurimi i ofertës” të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i

ndryshuar, si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik, i ndryshuar.

Në Nenin 83 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” citohet: “*Autoriteti Kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël*”. Në Nenin 82, të LPP, i ndryshuar “1. *Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet Kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik*”.

## **2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

**2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):** me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

### **Argumentimi:**

Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, i ndryshuar, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

## **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1** Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se dyfishi i vlerës së fondit limit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3 e LPP, i ndryshuar, si dhe nenin 43, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në dispozitat e legjislacionit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar. VKM-së nr.922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”.

Duke marrë në konsideratë specifikën e mallrave objekt procedure prokurimi, kërkohet që operatori ekonomik ofertues të paraqesë se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për ta realizuar atë në kohë dhe në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara. Për këtë, operatori ekonomik ofertues duhet të ketë disponibilitetin e duhur ekonomik dhe për këtë

qëllim, është argumentuar se vlera e xhiros për tre vitet e fundit financiare të jetë jo më e vogël se dyfishi i vlerës së fondit limit.

### **2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:**

**2.3.1** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës në një vlerë jo më të vogël se 40% e fondit limit.

*Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:*

a) Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

**Argumentimi:** Kriteri i mësipërm është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe nenit 40, pika 4, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % e vlerës limit të kontratës që prokurohet, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Duke marrë në konsideratë kontratën objekt prokurimi është menduar se vlera e kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të ketë realizuar me kontratat e ngjashme të jetë brenda vlerës kufi të përcaktuar në këtë mënyrë Autoriteti Kontraktor ka sigurinë dhe besueshmërinë që operatori ekonomik ofertues do realizojë me sukses kontratën objekt prokurimi.

**2.3.2** Operatori ekonomik duhet të paraqesë Autorizim nga Prodhuesi ose Distributor i Autorizuar për pajisjet që do të ofrojë.

*Dokumentacioni duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, e-mail, ëbsite kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij. Në rast se do të paraqitet autorizim nga distributori i autorizuar nga prodhuesi duhet të vërtetohet lidhja midis distributorit të autorizuar dhe prodhuesit.*

**Argumentimi:** Kriteri i mësipërm është në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Kërkesa për paraqitjen e autorizimeve të prodhuesve ose distributorëve se operatorët ekonomikë janë të autorizuar nga prodhuesi apo distributori i autorizuar është një dokument i rëndësishëm, pasi përveçse tregon origjinën e mallrave që kërkohen në procedurë, na garanton se ofertuesi është

i autorizuar për ofrimin tek AK të këtyre mallrave. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të mallrave që kërkohen të blihen e që janë prodhuar në përputhje me standardet. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE-se për përmbushjen me sukses të kontratës. Kriteri i mësipërm është në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

**2.3.3** Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij minimalisht 2 (dy) Inxhinier elektrik dhe 1 (një) Inxhinier mekanik.

**Në lidhje me kërkesën e mësipërme, gjatë ofertimit ofertuesi duhet të plotësojë në mënyrë të detajuar formularin përmbledhës të vetë deklaratimit dhe më pas, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari të paraqesë pranë Autoritetit Kontraktor, dokumentacionin i cili duhet të përputhet me atë të shprehur në formularin përmbledhës të vetë deklaratimit si:**

- ✚ Kontratë pune të vlefshme;
- ✚ Diploma;
- ✚ Listëpagesat e shoqërisë formulari E-sig, për të paktën Qershor 2024 – Gusht 2024.

**Argumentimi:** Kërkesat për punonjësit, janë kërkuar në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe nenit 40 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku me anë të këtij kriteri vërtetohet që operatorët ekonomikë dëshmojnë se kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të objektit të prokurimit. KESH sh.a, duhet të ketë besueshmërinë dhe të kërkojë garanci për realizimin me sukses të kontratës objekt prokurimi, duke përfshirë kërkesat për një staf të kualifikuar.

### **Konkretisht:**

- ✚ Inxhinieri elektrik - Duke qënë se disa nga detyrat që operatori ekonomik ofertues duhet të realizojë është edhe instalimi i pajisjeve në impiante të hapura me prezencë tensioni me nivel 13.8kV, kërkohet ekspertizë profesionale. Sa më sipër operatori ekonomik ofertues për realizimin me sukses të kësaj kontrate duhet të vërtetojë që ka në staf inxhinier me kualifikime dhe eksperiencë.
- ✚ Inxhinieri mekanik - Për zbatimin me sukses të kësaj kontrate është e nevojshme që operatori ekonomik të ketë në stafin e tij minimalisht 1(një) inxhinier mekanik pasi ndarësat e tensionit të mesëm janë mekanizma të ndërlikuara ku montimi dhe kalibrimi i tyre kërkon ekspertizë të lartë mekanike.

**2.3.4** Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij minimalisht 5 (pesë) punonjës të çertifikuar për sigurinë teknike për punë ndaj elektricitetit nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente me të, nga të cilët minimalisht 1(një) duhet të jetë i çertifikuar në grupin e sigurimit Teknik IV.

**Në lidhje me kërkesën e mësipërme, gjatë ofertimit ofertuesi duhet të plotësojë në mënyrë të detajuar formularin përmbledhës të vetë deklaramit dhe më pas, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari të paraqesë pranë Autoritetit Kontraktor, dokumentacionin i cili duhet të përputhet me atë të shprehur në formularin përmbledhës të vetë deklaramit si:**

- ✚ Kontratë pune të vlefshme;
- ✚ Diploma;
- ✚ Certifikata përkatëse;
- ✚ Listëpagesat e shoqërisë formulari E-sig, për të paktën Qershor 2024 – Gusht 2024.

**Argumentimi:** Kërkesat për punonjësit, janë kërkuar në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe nenit 40 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku me anë të këtij kriteri vërtetohet që operatorët ekonomikë dëshmojnë se kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të objektit të prokurimit. KESH sh.a, duhet të ketë besueshmërinë dhe të kërkojë garanci për realizimin me sukses të kontratës objekt prokurimi, duke përfshirë kërkesat për një staf të kualifikuar.

#### **Kontretisht:**

Daljet e gjeneratorëve me tension 13.8kV, janë ndërtuara me zbara të zhveshura dhe me izolim ajror. Këto lloj impiantesh me zbara të zhveshura kanë rrezikshmëri të lartë, pasi probabiliteti i kontaktit me përcjellësa nën tension është shumë i madh. Gjithashtu specialisti i kërkuar që të jetë i çertifikuar në grupin e sigurimit Teknik IV, duhet të kryej dhe të ndjek procesin e hapjes së fletëve të punës.

Sa më sipër operatori ekonomik ofertues për realizimin me sukses të kësaj kontrate duhet të garantojë sigurinë në punë gjatë instalimit dhe të vërtetojë që ka në staf me kualifikime dhe eksperiencë.

**2.3.5** Operatori Ekonomik ofertues duhet të paraqesë Katalogun/ët teknik për mallrat që do të furnizojë për këtë objekt prokurimi në mënyrë që të provohet pajtueshmëria me specifikimet teknike. *Në katalog, të markohen në mënyrë të qartë dhe të dallueshme mallrat e ofertuara, si edhe specifikimet përkatëse sipas të dhënave në DT. Katalogu të përmbajë karakteristikat teknike, me qëllim që AK të vlerësojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të përcaktuara në DT.*

**Argumentimi:** Kërkesa për paraqitjen e katalogut/ëve është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 40, pika 6, gërma b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Vendosija e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar, si dhe për të verifikuar përmbushjen e specifikimeve teknike të mallrave objekt prokurimi.

**2.3.6** Operatori ekonomik duhet të paraqesë test raporte zyrtare (type test) për pajisjet e mëposhtme:

- ✚ Ndarësa TM;
- ✚ Transformatorë tensioni;
- ✚ Zbara fleksibël;

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 40 pika 6 gërma (c) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Në përmbushje të kriterit të mësipërm Operatorët Ekonomike, duhet të paraqesin dëshmi të testeve zyrtare të ngjashme për ti krijuar bindjen AK se malli i ofruar është brenda parametrave të kërkuara.

**2.3.7** Operatori ekonomik duhet të paraqesë çertifikatë të materialeve përbërëse të zbarave fleksibël.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 40 pika 6 gërma (c) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Zbarat fleksibël janë nje shumë delikate që realizojnë kontaktin elektrik me përcjellshmërinë e duhur në pikat e bashkimit të elementëve të zbarave. Që operatori ekonomik ofertues të garantojë që përbërja e materialit është sipas kërkesave në specifikimet teknike duhet të paraqesë çertifikatën e materialeve përbërëse të zbarës.

**2.3.8** Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë Çertifikatat **ose ekuivalentet e tyre**, në përputhje me objektin e prokurimit, të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, si më poshtë:

- ✚ ISO 9001- “Sistemi i menaxhimit të cilësisë”;
- ✚ ISO 45001- “Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë”;
- ✚ ISO 50001- “Sistemi i menaxhimit të energjisë”;

**ISO 9001 “Sistemi i menaxhimit të cilësisë”** - Ky standard është i nevojshëm për çertifikimin në realizimin e cilësisë, identifikimin e rrisqeve, caktimin e burimeve të nevojshme për të kontrolluar nëse mallrat e ofruar janë të cilësisë së duhur si dhe kontrollin e proceseve.

**ISO 45001 “Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë”** - Ky standart është i nevojshëm për ndërgjegjësimin e gjithë personelit të shoqërisë në lidhje me masat e mbrojtjes së

shëndetit, sigurisë dhe konsultimit të punësuarve për vlerësimin e rrisqeve të shëndetit dhe sigurisë në punë.

**ISO 50001 “Sistemi i menaxhimit të energjisë”** – Ky standard është i nevojshëm për stimulimin e kontraktorëve për të gjetur mënyra në identifikimin e mundësive për të reduktuar konsumin e energjisë, duke konsideruar përfshirjen e stafit në këtë proces.

**Argumentimi:** Kërkesa në lidhje me këto certifikata është në përputhje me nenin 44 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar dhe nenin 79 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar.

**2.3.9** Operatori ekonomik duhet të paraqesë për pikën 14 të specifikimeve teknike “Lista e mallrave dhe punimeve”, A.Lista e mallrave, për zërat 8,9,10,11. Bashkues fleksibël modeli 1-4, mostër për zërat e mësipërm.

*Dorëzimi i mostrës të bëhet ditën dhe orën e hapjes së tenderit para Komisionit të Vlerësimit të Ofertave. Së bashku me mostrën, ofertuesi duhet, ta bëjë shoqërimin e saj me një shkresë të firmosur nga përfaqësuesi ligjor dhe vulosur ku të listohet mostra e paraqitur. Mosparaqitja e te gjitha mostrave është kusht për skualifikim.*

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77 të ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 40, pika 6, gërma a) të VKM Nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar si dhe për të verifikuar përmbushjen e specifikimeve teknike të mallrave të kërkuara si mostra duke u nisur nga pesha dhe rëndësia që ato kanë për mbarëvajtjen e proceseve të punës. Ky kriter siguron AK -në që përmasat dhe përbërja e e zbarave fleksibël të ofertuara janë sipas specifikime teknike të kërkuara nga AK.

**2.3.10** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesi licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, sipas formatit të miratuar me *VKM nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”*. Shqyrtimi i licencave do të bëhet mbi bazën e rregullave të parashikuara sa më sipër. Licenca profesionale e Operatorit Ekonomik lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës duhet të përmbajë kategoritë e mëposhtme:

NS-14 A Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiofoni, TV etj.

*Shoqëritë e huaja duhet të bëjnë ekuivalentimin e licencave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM-në, Nr.42, datë 16.01.2008). Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 40 pika 8 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Edhe pse kemi të bëjmë me një procedurë të llojit mall, referuar specifikimeve teknike dhe kërkesave të zbatimit të kontratës nga Autoriteti Kontraktor është e nevojshme që operatori ekonomik të vërtetojë se është i licensuar pikën e licensës NS-14 A.

***Të gjitha dokumentet duhet të paraqiten origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.***

**Shënim:** Në respekt të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, në të gjithë rastet në kur dokumentet e tenderit përmendet “markë” përfshihet termi “ose ekuivalenti i tij/saj”.

**Në rast të ofertave nga ofertues të huaj, dokumentet e ofertës duhet të jenë ekuivalente me dokumentet e kërkuara sipas parashikimeve ligjore të fushës për njehsimin e dokumenteve.**

#### **I. Argumentimi i specifikimeve teknike:**

*Specifikimet teknike janë hartuar duke marrë në konsideratë nevojat e Autoritetit Kontraktor, sipas parashikimeve të nenit 36 të Ligjit Nr. 162, date 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar.*

Specifikimet teknike për të gjithë mallrat objekt prokurimi janë hartuar referuar parametrave elektrike të zbarave të gjeneratorëve, rrymave se lidhjes se shkurter ne zbarat e transformatoreve etj. Përmasat konstruktive të ndarësave të transformatorëve të fuqisë dhe tensionit janë kërkuar referuar vendn-istalimit ekzistues. Për hartimin e kërkesave për mallrat objekt prokurimi janë marre për reference standartet IEC/EN dhe standartet shqiptare.

#### **Njësia e Prokurimit**